



Instructions For Use FSG-Imprint-Foam

Ideal · Genial XL · Diabetic Step · Maximal · Minimal
PodoScann · SlimLine · Kristall



1. Preparation

note the name of the customer and date the impression was taken on the foam box. Open the box and with the Foam sides facing up at one. Lay a solid, level surface.



2. Heel

The patient's foot is centered on the foam sheet place and carefully on the Deposit foam surface. Well the check the perfect position of the foot. If the foot is not on the foam everywhere, correct now. Start with the By guiding your hand deep into the heel Press foam.



3. Metatarsus

Push the base M5 (midfoot) with the edge of the hand.



4. Big toe joint

Now press the big toe joint as well with the back of your hand in the foam. Relocate the power of your hand afterwards on your edge of your hand and use it to press the individual toes also.



5. Completion / repetition

Now take the foot vertically upwards from the foam. Repeat the the o.g. Processes with the other foot. Usability check the imprint, if necessary with a new one Repeat the pair of impression foams. Foam residues on the foot are made hygienic Reasons to remove immediately. FSG impression foam store separately with imprint.



ALBANIA



Manual përdorimi - Shkumë FSG për marrjen e gjurmëve

1. Qëllimi i përdorimit:

Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve i nevojitet personelit të specializuar në teknologjinë e këpucëve ortopedike, për të krijuar gjurmët e këmbëve. Tekniku ortopedik krijon për shkak të diagnozës së një mjeku një gjurmë negative të këmbës. Kjo gjurmë negative mund të përpunohet më tej nga tekniku ortopedik në mënyra të ndryshme. Ai mund të përgatisë me allçi ose me rrëshirë të derdhur një pozitiv, ose me anën e gjurmës të përcaktojë anatominë e saktë ose pika të caktuara të këmbës. Ekziston gjithashtu mundësia që gjurma e këmbës të skanohet dhe të përpunohet më tej me softuerë special. Në rast se kryhet një gjë e tillë duhen respektuar informacionet e prodhuesit të skanerit dhe të lëvruesit të softuerit. Në shumicën e rasteve përgatitet një shollë, por ekzistojnë edhe mundësi të tjera, si p.sh. prodhimi i një këpuce me masë individuale. Një kombinim me produkte të tjera nuk është parashikuar.

2. Magazinimi:

Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve duhet ruajtur në një vend të thatë, kushtet ideale të ambientit janë temperatura ndërmjet 18° dhe 24° C dhe një lagështi ajri relative ndërmjet 55% dhe 65%. Për cilësinë e produktit dhe funksionimin në rast se magazinimi kryhet jashtë këtyre kushteve nuk mund të merret përsipër asnjë garanci. Kutitë e dëmtuara ose të lagura të shkumës për marrjen e gjurmëve duhen hedhur. Kutitë e kartonit me të cilat ajo lëvrohet duhet të magazinohen në këmbë, nuk është parashikuar magazinimi i tyre në pozicion të shtrirë. Lejohet që maksimumi të vendosen 4 kuti kartoni mbi njëra-tjetrën.

3. Përdorimi:

Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve lejohet të përdoret vetëm nga personeli i specializuar i trajnuar. Përdoruesi duhet që gjatë punës, për vetë-mbrojtje të mbajë doreza mbrojtëse me një përdorim. Rregullat e mbrojtjes në punë duhen respektuar. Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve është e përshtatshme vetëm për përdorimin në sipërfaqe dhe mund të përdoret vetëm njëherë. Një pacient lejohet që të shkelë vetëm njëherë mbi pllakën e shkumës. Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve duhet të jetë e thatë dhe jo e dëmtuar. Këmba e pacientit duhet të jetë e pastër, jo e kremosur dhe pa asnjë dëmtim ose infeksion. Nëse është e nevojshme duhet përdorur plastmasë ose fasho për plagët për mbulimin e këmbës. Kontakti i shkumës FSG për marrjen e gjurmëve ose fërkimi i saj me mukozat duhet mënjauar. Para përdorimit duhet garantuar që varianti i përdorur është lloji i përshtatshëm për përdorimin e planifikuar. Përdoruesi i specializuar i trajnuar përcakton shkumën e nevojshme mbi të cilën duhet shkelur bazuar në përdorimin e saj. Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve duhet të jetë e hapur dhe të jetë vendosur mbi një sipërfaqe të fortë, horizontale dhe të sheshtë. Këmba duhet udhëhequr nga përdoruesi, për të arritur një gjurmë të qendërzuara. Në rastin e një gjurme me ngarkesë të plotë (duke qëndruar në këmbë) duhet të kujdeseni që pacienti të qëndrojë i sigurt ose të mbështetet diku. Kontrolloni nëse gjurma mund të përdoret, nëse është e nevojshme përsëriteni atë me një çift të ri shkume për marrjen e gjurmës. Mbetjet e shkumës në këmbë duhen larguar menjëherë për arsye higjienike. Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve bashkë me gjurmë duhet ruajtur në një vend të veçantë.

4. Skadencia:

Shkuma FSG për marrjen e gjurmëve nuk lejohet të ruhet më shumë se 36 muaj. Ndryshimet e ngjyrës nuk ndikojnë në funksionimin e shkumës. Data e vulosur mbi paketimin e produktit tregon datën e skadencës. Pas kësaj date shkuma nuk lejohet të përdoret më. Vula e datës është edhe paketës. Data në etiketën e paketimit të njësisë së transportit pas simbolit „ora“. Specifikon datën e skadimit (muajin). Pas kësaj date forma është e papërdorshme. Dita e LOT është gjithashtu numri i grupeve.

5. Hedhja:

Shkuma FSG pBatchr marrjen e gjurmëve hidhet tek plehtrat normal, kutitë e kartonit dërgohen në riciklimin e letrave të përdorura. Shkuma e kontaminuar për marrjen e gjurmëve dhe nëse është e nevojshme edhe paketimi duhen hedhur në atë mënyrë, që të jetë në përputhje me llojin e ndotjes si dhe me rregulloret vendore ligjore për trajtimin e mbetjeve.



Formschaum Gronau GmbH
Marie-Curie-Str. 18 · D-48599 Gronau
Telefon +49 (0) 25 62 / 90 767 60
Telefax +49 (0) 25 62 / 90 767 66
orders@formschaum-gmbh.de
www.formschaum-gmbh.de